

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI,**

**NDËRMJET**

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**DHE**

**FEDERATËS SHQIPTARE TË SPORTIT SHKOLLOR**


**PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE DHE GARANTIMIN E SPORTIT CILËSOR  
NË SHKOLLË**

Mbështetur në nenin 59, të Kueshtetutës, në ligjin nr.9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", në ligjin nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

Me qëllim masivizimin dhe rritjen cilësore sportive në shkollat publike dhe jopublike të sistemit parauniversitar, si dhe evidentimin e talentëve sportive.

Palët në këtë marrëveshje, Këshilli i Ministrave, si përfaqësues i shtetit shqiptar, në emër të institucioneve të saj qeverisëse, dhe Federata Shqiptare e Sportit Shkollor, regjistruar si e tillë me vendim gjykate, në vijim Federata (FSHSSH).

Bien dakort dhe nënshkruajnë, si më poshtë vijon:



Kjo marrëveshje përcakton çështjet dhe drejtimit kryesore të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve qendrore shtetërore e lokale dhe Federatës Shqiptare të Sportit Shkollor (FSHSSH), si dhe prioritetet e mundësitë shtetërore në mbështetje të organizimit dhe realizimit të programit të saj për edukimin fizik dhe veprimtaritë sportive në shkollat shqiptare të sistemit parauniversitar.

**Neni 2  
Qëllimi**

Palët nënshkruese bien dakord që, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, të ndihmojnë njëra-tjetrën për krijimin e kushteve optimale dhe garantimin e mbështetjes shtetërore për zgjerimin, rritjen dhe masivizimin e edukimit fizik e të sportit, si udhëzuesi i vetëm objektiv e praktik, i cili krijon shtratin shoqëror për zhvillimin e sportit, evidentimin e talentëve dhe derivateve të tij, bazuar mbi parimet shkencore, si garanci për progresin fizik, psikologjik, intelektual, ekonomik e produktiv të rinisë shkollore, si dhe për rritjen e mirëqenies së shqiptarëve.

### **Neni 3**

#### **Zbatimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje i shtrin efektet mbi:

1. të gjitha organet dhe institucionet shtetërore, që kanë të bëjnë me sportin, arsimin, edukimin, bashkësinë VUSH, si dhe institucionet e personat juridikë të themeluar prej kësaj bashkësie;
2. të gjitha federatat, klubet sportive, shoqatat, antarët e federatave, mësuesit, trajnerët etj. që do të përfshihen dhe do të bashkëpunojnë për realizimin e programit të FSHSSH-së.

### **Neni 4**

#### **Detyrimet objektive të Këshillit të Ministrave**

Këshilli i Ministrave merr përsipër që në çdo vendimmarrje në fushën e arsimit dhe sportit t'i kushtojë vëmendjen maksimale gjetjes së zgjidhjeve më të mira, në funksion të çështjeve, objekt të kësaj marrëveshjeje, duke u konsultuar paraprakisht dhe duke konsideruar çdo kërkesë e objektiv të paracaktuar të Federatës.

### **Neni 5**

#### **Mbështetja e Këshillit të Ministrave për programin e FSHSSH-së**

Këshilli i Ministrave e konsideron FSHSSH-në dhe programin e saj si një vlerë të shtuar kombëtare në vazhdim të objektivave të saj strategjike për edukimin fizik dhe sportin në sistemin arsimor dhe e vlerëson mbështetjen e këtij programi si një domosdoshmëri, e cila i jep FSHSSH-së mundësinë që ajo të realizojë objektivat e saj.

Këshilli i Ministrave do të mbështetë FSHSSH-në nga ana organizative dhe financiare për të realizuar programin e saj.

### **Neni 6**

#### **Mbështetja organizative e programit të FSHSSH-së**

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për sportin, merr përsipër mbështetjen tërësore të programit të FSHSSH-së, për të arritur qëllimet e saj kombëtare për zgjerimin, rritjen dhe masivizimin e edukimit fizik e të sportit në sistemin parauniversitar, në terma afatshkurtër, afatmesmë dhe afatgjatë.

Mbështetja e këtij programi do të sigurohet edhe nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit me ministritë e tjera, bashkitë apo insitucionet e organizmat e tjerë, që përmenden në nenin 3, të kësaj marrëveshjeje.

Këshilli i Ministrave do ta drejtojë mbështetjen e tij organizative për programin e FSHSSH-së në të tria boshtet kryesore të saj:

1. Objektivat strategjike të programit të FSHSSH-së, si:

- ngritja e strukturave të FSHSSH-së;
- krijimi i rrjetit të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit për t'u përfshirë natyrshëm në shkëmbimin e eksperiencave të shumanshme sportive dhe jo vetëm të standardit të zhvilluar sportiv, evropian;
- programe studimore, shkencore dhe organizative, afatshkurtra, afatmesme, afatgjata;
- veprimtaritë masive, zonale, rajonale dhe kombëtare, fiziko-sportive në gjithë sistemin arsimor parauniversitar dhe organizmi i tyre mbi baza shkencore;
- rehabilitimi dhe shfrytëzimi i mjediseve sportive dhe krijimi i mjediseve të reja;
- nxitja dhe pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plane, programe dhe aktivitete sportive;
- evidentimi i talenteve në sport, nxitja, promovimi i tyre dhe kthimi në dukuri;
- përcaktimi i politikave për aktivitetin fizik dhe sportin në sistemin arsimor parauniversitar studim, trajnim, implementim dhe rezultat.

## 2. Planin e veprimit për realizimin e programit të FSHSSH-së:

- Hapi parë..... Bashkëpunim me qeverinë;
- Hapi dytë..... Krijim projektesh;
- Hapi tretë..... Financim projektesh;
- Hapi katërt..... Bashkëpunim me investitorët;
- Hapi pestë ..... Menaxhimi i projekteve dhe gjenerim të ardhurash.

## 3. Krijimi i ekipit administrativ dhe strukturave mbështetëse, që do të realizojnë programin e FSHSSH-së.

### Neni 7

#### Drejtimit kryesore të mbështetjes organizative të Këshillit të Ministrave

Mbështetja organizative e Këshillit të Ministrave do të konsistojë në:

- a) vënien në dispozicion të aseteve, në përputhje me parashikimet e nenit 9, të kësaj marrëveshjeje;
- b) disponueshmërinë e institucioneve për dhënien e informacioneve respektive, të cilat janë të nevojshme për të kontribuar në arritjen e objektivave nga FSHSSH-ja; mbështetjen logjistike; ruajtjen dhe garantimin e sigurisë së aktiviteteve; mbështetjen financiare nga bashkitë dhe bashkëpunimin e bashkëpjesëmarrjen e tyre;
- c) realizimin e projekteve që kërkojnë financime të mëdha jashtë aktiviteteve të zakonshme, nëpërmjet:
  - krijimit të lehtësimeve të nevojshme për realizimin e këtyre projekteve, sikundër janë projektet për zhvillimin e terreneve, lehtësitë në veprimet administrative, në dhënien e informacionit të nevojshëm, lehtësive fiskale, mbështetjen me

financim të pjesshëm të projektit, si dhe suportin e mbështetjen e plotë organizative për këto investime;

- garantimit të investitorit për investimin e tij dhe për projektin që ai do të financojë;
  - mbështetjes së plotë të organeve qendrore dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, veçanërisht, të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin, DAR/ZA-të, etj. për krijimin e një besimi të plotë për investitorin, për jetëgjatësinë dhe vazhdimësinë e projektit që ai do të financojë, nëpërmjet një menaxhimi të suksesshëm.
- ç) vënien në dispozicion të FSHSSH-së të programeve e të kurrikulave, në funksion të veprimtarive sportive e të angazhimit të trupës pedagogjike;
- d) vënien në dispozicion të FSHSSH-së të terreneve sportive shkollore dhe krijimin e lehtësive në organizimin e veprimtarive e të kampionateve sportive brenda dhe ndërmjet shkollave;
- dh) pjesëmarrjen e përfaqësuesve të FSHSSH-së në veprimtaritë shkencore, studimore dhe në konferencat tematiko-sportive, që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit.
- e) bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të FSHSSH-së me DAR/ZA-të, për realizimin e projekteve të ndryshme, brenda programit të saj, dhe me ndërmjetësinë e ministrisë përgjegjëse për arsimin kur kjo është e domosdoshme.
- ë) njohjen, veçanërisht nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin, të përfaqësuesve të FSHSSH-së në shtetet e ndryshme, me standarde të larta fiziko-sportive, për të zhvilluar me tej infrastrukturën dhe kulturën tonë sportive.

### **Neni 8 Mbështetja financiare**

Mbështetja e Këshillit të Ministrave në aspektin financiar do të konsistojë në:

- a) mbështetjen financiare buxhetore për FSHSSH-në, minimalisht për fondin e pagave të administratës së federatës, si një domosdoshmëri për të kompletuar dhe për të bërë realitet kombëtar objektivat strategjikë të saj dhe planin e veprimit ;
- b) mundësimin e pajisjes me mjedise pune për funksionimin e administratës së federatës ;
- c) mbështetjen për një planifikim vjetor në buxhetin e çdo bashkie për të mbështetur projektet që do të ofrojë FSHSSH-ja për bashkitë respektive.

## **Neni 9**

### **Mbështetja materiale**

Ndërmarrjet/institucionet shtetërore, përfaqësues të pronarit shtet ose që kanë në administrim prona të paluajtshme shtetërore, si terrene e mjedise sportive, sheshe apo rrugë që mund të përdoren për veprimtari sportive, me kërkesë të Federatës do t'ia vënë ato në dispozicion, pa pagesë, me qëllim organizimin dhe zhvillimin e kampionateve rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, të ekipeve të përzgjedhura të nxënësve të shkollave.

## **Neni 10**

### **Siguria dhe paprekshmëria e nxënësve sportistë**

FSHSSH-ja për çdo veprimtari apo kampionat të rëndësishëm të nxënësve/ekipeve sportive të shkollave, të cilat organizohen prej saj, merr përsipër që të njoftojë dhe të kërkojë nga organet policore vendore marrjen e masave për sigurinë fizike.

Policia e Shtetit, për çdo kërkesë të Federatës, harton planet e masave dhe urdhëron strukturat e saj përgjegjëse për organizimin e shërbimeve për ruajtjen e rendit dhe garantimin e sigurisë fizike të pjesëmarrësve, nxënës sportistë, në veprimtarinë apo kampionatin që do të zhvillohet.

## **Neni 11**

### **Rritja e treguesve shëndetësorë të nxënësve**

Institucionet shtetërore, përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë, së bashku me FSHSSH-në, të hartojnë dhe të kontrollojnë zbatimin e programeve të përbashkëta për përcaktimin e masave që duhet të ndërmerren në shkolla dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e treguesve shëndetësorë të nxënësve.

Organet shëndetësore, rajonale apo të specializuara, nën kujdesin dhe në bashkëpunim me Federatën organizojnë kontrole periodike mjekësore, veçanërisht për nxënësit sportistë.

Realizimi dhe implementimi i platformës së edukimit fizik, si një bazë themelore e krijimit të një kulture kombëtare të edukimit fizik dhe sportit, do të monitorohen në mënyrë të organizuar dhe të përbashkët me grupe specialistësh nga FSHSSH-ja, ministritë përgjegjëse për arsimin, sportin dhe shëndetësinë, për të monitoruar në kohë reale zbatueshmërinë, treguesit dhe efektet e këtij implementimi.

Zhvillimi i kampionateve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, të ekipeve të përzgjedhura të nxënësve të shkollave apo veprimtaritë e tjera me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve sportistë, me kërkesë të Federatës, do të asistohen dhe do të mbështeten me logjistikën e plotë sportive dhe mjekësore, në bashkëpunim kjo respektivisht me ministritë përgjegjëse.

## **Neni 12**

### **Planifikimi dhe ndërtimi terreneve sportive**

Ministria dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për çështjet e planifikimit të territorit dhe projektimit, gjatë fazës së hartimit të masterplaneve të qyteteve apo të projektimit a miratimit të lejeve për ndërtimin e terreneve sportive, për përdorim publik, të konsultohen me Federatën që këto objekte të plotësojnë kërkesat teknike për përmbushjen e kërkesave të zhvillimit të veprimtarive me nxënës sportistë.

Organet shtetërore të administrimit të territorit me kërkesë dhe në bashkëpunim me Federatën të vlerësojnë, si prioritare, mundësinë e dhënies së shesheve apo ndërtimin e terreneve sportive në funksion të një apo të disa shkollave, si dhe të komplekseve shumësportëshe për organizimin e veprimtarive dhe kampionatëve ndërmjet shkollave apo për zhvillimin e stërvitjeve të ekipeve dhe nxënësve sportistë.

FSHSSH-ja nëpërmjet administratës së saj përgatit projektet për këtë qëllim dhe, në bashkëpunim me insitucionet përkatëse të bashkive respektive, do t'i bëjë ato pjesë të studimeve dhe implementimeve afatgjata të masterplaneve për secilin qytet.



## **Neni 13**

### **Programimi i bashkëpunimit**

Për bashkëpunimin ndërmjet ministrive përkatëse, përgjegjëse, bashkive, DAR/ZA-ve dhe FSHSSH-së, duhet të krijohen modulet e nevojshme që natyrshëm t'i shërbejnë realizimit të projekteve që parashikon programi i FSHSSH-së, veçanërisht, për :

- a) evidentimin e terreneve dhe përcaktimin e programeve të shfrytëzimit të tyre ;
- b) hartimin e marrëveshjeve mbështetëse të financimit ;
- c) organizimet me bashkitë për realizimin e programit të FSHSSH-së dhe për promovimet e ekipeve të shkollave ;
- ç) shfrytëzimin dhe zhvillimin e terreneve sportive ekzistuese dhe mënyrat për rritjen e mëtejshme të këtyre hapësirave;
- d) përcaktimin e sipërfaqeve të nevojshme në funksion të projekteve respektive.

## **Neni 14**

### **Talentet sportive dhe promovimi i tyre**

FSHSSH-ja, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, garanton realizimin e misionit të saj : “Masivizimi i edukimit fizik dhe sportit, si udhëzuesi i vetëm objektiv e praktik, i cili krijon shtratin shoqëror për zhvillimin e sportit, talenteve dhe derivateve të tij, bazuar mbi parimet shkencore, si garanci për progresin fizik, psikologjik, intelektual, ekonomik, produktiv dhe të mirëqenies së shëndetshme të shqiptarëve.”.

Përmbushja e objektivit strategjik të FSHSSH-së për trajtimin e talenteve në disiplinën të ndryshme të sportit, si një aset të çmuar kombëtar, do të meritojë të gjithë trajtimin shkencor dhe menaxherial nga federata, për këtë qëllim.

Programet strategjike të FSHSSH-së në këtë drejtim përfshijnë, pa u kufizuar,:

- a) zbulimin, nxitjen, promovimin dhe stimulimin e talenteve në disiplina të ndryshme sportive;
- b) stimulimin e tyre, nëpërmjet programeve dhe projekteve të veçanta, nxitëse dhe zhvilluese;
- c) promovimin e tyre në arenën kombëtare dhe ndërkombetare;
- ç) bashkëpunimin me ekipe ndërkombëtare të zhvilluara, të cilat do të krijojnë këmbimin e eksperiencave mes nesh dhe talenteve tona dhe më tej edhe në ekipet e tyre;
- d) krijimin dhe promovimin e figurës së talentit si një model stimulues për të rinjtë dhe nxënësit.

Menaxhimi i këtyre talenteve do të paraprihet me krijimin e një infrastrukture ligjore nga FSHSSH-ja, e cila do të sigurojë hapësirat e nevojshme për këto talente, brenda dhe jashtë vendit, në bashkëpunim dhe duke u mbështetur nga bashkia, ministria, Federatat e Klubeve Sportive etj.

### **Neni 15**

#### **Nxitja dhe pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi ndryshe në veprimtari sportive**

Programi i FSHSSH-së është gjithëpërfshirës dhe do të trajtojë me shumë kujdes dhe në mënyrë shkencore fëmijët me aftësi ndryshe me qëllimin final integrimin në mënyrë të natyrshme të kësaj pjese të shoqërisë shkollore me pjesën tjetër.

Programet për këtë qëllim përfshijnë pa u kufizuar:

- a) studime dhe programe për të përcaktuar në mënyrë shkencore natyrën e projekteve që do të përdoren për këtë qëllim;
- b) organizimin dhe krijimin e veprimtarive gjithëpërfshirëse, si gara, kampionate, kampingje, ekskursione etj. të kësaj natyre;
- c) krijimin e aktiviteteve sportive;
- ç) nxjerrjen e talenteve mes tyre dhe bashkëpunimin me ta;
- d) realizimin e bashkëpunimit FSHSSH-prindër-shkolla-ministri përgjegjësetj.

### **Neni 16**

#### **Masivizimi i edukimit fizik dhe sportit, si zanafillë te kopshtet**

Kultura fiziko-sportive dhe masivizimi i saj e ka orgjinën dhe fillësën e saj te edukimi fizik dhe sporti në kopsht dhe, më tej, në vazhdimin e saj nëpërmjet rrugës së sigurt në shkollë, e cila do të krijojë bazën e edukimit e të masivizimit të sportit për shoqërinë shqiptare, duke kuptuar që sporti sot është masivitet sportiv dhe talent nesër. Ndaj, në programin e saj FSHSSH-ja parashikon krijimin e programeve të veçanta shkencore, për këtë qëllim, në kopshte, të cilat përfshijnë, pa u kufizuar,:

- a) realizimin e studimeve, projekteve dhe programeve, për këtë qëllim;
- b) sensibilizimin, trajnimin dhe bashkëpunimin me mësuesit e kopshteve;
- c) organizimin dhe krijimin e aktiviteteve gjithëpërfshirëse etj., të kësaj natyre;

- ç) bashkëpunimin midis ministrive përgjegjëse për arsimin e shëndetësinë dhe FSHSSH-së.

### **Neni 17**

#### **Aktivite masive sportive me nxënësit e shkollave**

Bashkëpunimi dhe mbështetja e FSHSSH-së për zbatimin e programit të saj ambicioz në organizimet fiziko-sportive, si një element thelbësor i masivizimit, socializimit dhe edukimit fizik dhe sportit, duke përfshirë në to DARZA-të, bashkitë, nxënësit, prindërit, komunitetin, në aplikim të të gjithë spektrit të disiplinave sportive, si kros, ciklizëm, futboll etj. si dhe më tej në organizime më të zgjeruara komunitare si ekskursionet, aktivitete sportive në terrene, duke bërë njëkohësisht evokim historik dhe kulturor, nëpërmjet një boshti fiziko-sportive-argëtues.

Bashkëpunimi organizativ mbështetet në marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet të gjithë aktorëve përgjegjës dhe paraprihet nga:

- a) studimi identifikues në aspektin sportiv, kluturor, historik, zonal, në sinkron me eksperiencën, kulturën dhe trashëgiminë fiziko-sportive të zonës, për të kuptuar dhe çuar më tej aspektin trashëgues të secilit qytet, në ato disiplina sportive, të cilat në bashkërendim me kulturën historike sjellin në të gjitha rastet masivizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj;
- b) krijimi i programeve dhe modeleve specifike për secilin qytet;
- c) hartimi i programeve kalendarike për zhvillimin e kroseve dhe kampionateve të disiplinave të ndryshme sportive, midis shoqatave rajonale të sportit shkollor, kombëtar dhe më tej, në aktivitetet sportive ndërkombëtare përkatëse.
- ç) promovimi dhe sensibilizimi i këtyre programeve.

### **Neni 18**

#### **Veprimtaritë shkencore dhe kualifikuese**

Bashkëpunimi dhe mbështetja e FSHSSH-së për zbatimin e programit të saj në krijimin e formave dhe modeleve të transmetimit të dijeve shkencore kualifikuese si në apsketin e disiplinave sportive, ashtu edhe në aspektin ngritjes së cilësisë intelektuale të nxënësve, mësuesve, trajnerëve dhe të vetë shoqërisë.

Ky qëllim bashkëpunimi dhe mbështetja konsistojnë, por jo vetëm, në:

- a) studimin paraprak, nëpërmjet ngritjes së grupit të përbashkët të ekspertëve, për vlerësimin e nivelit kulturor dhe shkencor të mësuesve, trajnerëve dhe nxënësve në dietët e sotme;



- b) krijimin dhe realizimin me standarde perëndimore të programeve studimore, shkencore, trajnimeve, licensimeve dhe sesioneve shkencore;
- c) krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet FSHSSH-së dhe atyre më të zhvilluara dhe organizimi përbashkët i seminareve, leksioneve apo trajnimeve me standarde të larta perëndimore;
- ç) krijimin e kurikulave për trajnime të specializuara të mësuesve e të trajnerëve për sportin dhe edukimin fizik;
- d) krijimin e modeleve të bashkëpunimit ndërmjet FSHSSH-së, federatave të tjera, ministrisë, DARZA-ve dhe bashkive.

### **Neni 19**

#### **E drejta e autorësisë së aktiviteteve**

FSHSSH-ja së bashku me bashkëpunëtorët e saj gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale të çdo projekti që ajo do të bëjë dhe do të realizojë në ose nëpërmjet shkollave apo institucioneve shtetërore, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

FSHSSH-ja ka të drejtën e plotë të menaxhimit të të gjitha projekteve të saj si një e drejtë e pronës së saj intelektuale.

FSHSSH-ja ka të drejtën e përfitimit të të ardhurave që do të rrjedhin nga implementimi dhe menaxhimi i projekteve që ajo do të realizojë, brenda gjithë kuadrit që lejon legjislacioni shqiptar, si mundësia e saj e vetme për të ruajtur dhe për të forcuar më tej shëndetshëm organizimin e saj dhe për të realizuar objektivat e saj strategjike kombëtare.

### **Neni 20**

#### **Bashkëpunimi me Federatat**

Institucionet shtetërore përgjegjëse do të ofrojnë ndihmesën e tyre për realizimin e një bashkëpunimi të suksesshëm të FSHSSH-së me federatat e tjera vendase ose të huaja, për realizimin e projekteve, në drejtime të ndryshme dhe implementimin e tyre, në funksion të përbushjes së objektivave të kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 21**

#### **Përbushja e funksioneve të federatës**

FSHSSH-ja për qëllimet e kësaj marrëveshjeje do të pëmbushë këto objektiva dhe detyra:

1. Të shërbejë si koordinatorë, nxitëse dhe bashkëpunëtorë me organizmat qeveritarë dhe joqeveritarë, qendrore dhe lokalë, për masivizimin dhe zhvillimin e

- lëvizjes fiziko –sportive në sistemin arsimor, në përputhje me platformën e edukimit fiziko-sportiv të ministrisë përgjegjëse për sportin dhe konventat ndërkombëtare dhe rajonale të fushës së edukimit fizik dhe sportit.
2. Të përfaqësojë dhe të bashkëpunojë për të mbrojtur interesat e mësuesve të edukimit fizik dhe të kontribuojë për kualifikimin progresiv të tyre, nëpërmjet seminareve dhe aktiviteteve të ndryshme informuese dhe zhvilluese për fushën e edukimit fizik dhe sportit, në përputhje me standardet bashkëkohore.
  3. Të kontribuojë për një zhvillim të gjithanshëm dhe harmonik fiziko-lëvizor, sportiv, funksional, psikologjik, intelektual, social, në funksion të shëndetit të rinisë shkollore, me qëllim aftësimin e tij përballë sfidave të jetës:
  4. Të kontribuojë për ndërgjegjësimin e mënyrës së ushqimit, praktikimit të aktivitetit fizik dhe sportit, luftës kundër duhanit dhe përdorimit të substancave abuzive, luftës kundër dopingut në sport, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së ambienteve sportive në shkollë, si dhe të kushteve natyrore, si faktorë thelbësorë të rëndësishëm në cilësinë e shëndetit.
  5. Të kontribuojë me programe dhe projekte konkrete në përmirësimin e infrastrukturës sportive në shkollë, për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik dhe sportit në shkollë, në përputhje me standardet bashkëkohore.
  6. Të kontribuojë me programe dhe projekte ku përfshihen studime, trajnime, sesione shkencore, projekte për aktivitete, krose, kampionate, ekskursione me temë sportive shkollore, kampinge të ndryshme, promovime, të kulturës dhe traditës sportive, projekte dhe studime për përmirësimin e raportit (Teren i gjelbër sportiv/për nxënës) sipas standardit evropian.
  7. Të kontribuojë në mënyrë aktive në krijimin e projekteve, të kërkojë dhe të krijojë mundësi reale për gjetjen e burimeve të financimit për projekte të programit të saj, duke synuar në mënyrë esenciale përfshirjen në programet e financimit nga investitorë strategjikë, si komuniteti evropian, Banka Botërore, BERZH-i etj.
  8. Të krijojë programe të veçanta për trajtimin dhe promovimin e talenteve në të gjitha disiplinat sportive duke krijuar module bashkëpunimi dhe realizimi, largpamëse dhe premtuese për talentet.
  9. Të nxitë dhe të promovojë zhvillimin e të gjitha disiplinave sportive, si dhe aktivizimin e ekipeve të shkollave dhe talenteve respektive.
  10. Të bashkëpunojë me federatat e sportit shqiptar për të bashkërenduar zhvillimin masiv dhe cilësor të ekipeve zinxhirë të disiplinave përkatëse.
  11. Të programojë dhe të organizojë zhvillimin e kampionateve të disiplinave të ndryshme sportive, midis shoqatave rajonale të sportit shkollore dhe të përfaqësojë Shqipërinë në aktivitetet sportive ndërkombëtare respektive për ekipet e shkollave.
  12. Të nxitë dhe të iniciojë bashkëpunime dhe shkëmbime eksperiencash në fushën e edukimit fizik dhe sportit, brenda dhe jashtë vendit.
  13. Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive shkollore ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj.

## **Neni 22**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.

2. Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje mund të bëhen me mirëkuptim e marrëveshjes midis palëve.
3. Për të gjitha çështjet e përbashkëta në të cilat do të ketë mendime të ndryshme, Federata dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të gjejnë një qëndrim të njëjtë, duke pranuar ndërmjetësimin e ministrisë përgjegjëse për sportin për zgjidhjen e gjithëpranuar.

**Neni 23**  
**Dispozita të fundit**

1. Shteti i njeh të drejtën bashkësisë së Federatës që të lidhë marrëveshje të veçanta me institucionet qendrore dhe njësitë vendore për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.
2. Kjo marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta me Federatën, që do të miratohen sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Marrëveshjet e veçanta, që lidhen me Federatën në bazë të kësaj marrëveshjeje, regjistrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Secila palë mund ta denoncojë me shkrim marrëveshjen. Në rast të tillë, marrëveshja do të skadojë në ditën e tridhjetë (30) pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin, palës tjetër.
5. Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit.

PËR  
KËSHILLIN E MINISTRAVE



PËR  
FEDERATËN SHQIPTARE  
TË SPORTIT SHKOLLOR

Tiranë me 2.11.2016